



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 52

Prishtinë, më 29.3.2017, në ora: 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Xhevahire Izmaqu, Sadri Ferati, Zenun Pajaziti, Shqipe Pantina, Lahi Brahimaj dhe Zafir Berisha.

Munguan: Kujtim Paçaku, Agim Kikaj dhe Jelena Bontiq.

Në mbledhje morën pjesë: Mahir Yagcilar, ministër dhe përfaqësuesit e MAP-së, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, OSBE, INPO, RTK, Koha ditore, Kosovapress.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi, Xhevahire Izmaqu, kryetare e Komisionit, me këtë rend të ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Raportimi i ministrit të Ministrisë së Administratës Publike, z. Mahir Yagcilar;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, për vitin 2016;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Raportimi i ministrit të Ministrisë së Administratës Publike, z. Mahir Yagcilar

Kryetarja e Komisionit, njoftoi komisionin mbi bazën e informatës, që një grup punues, i përbërë nga përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe Komisionit Parlamentar për Buxhet,

janë duke punuar për reformën në administratën publike. Arsyeja e ftesës së ministrit ishte për të raportuar për reformën në administratën publike.

Mahir Yagcilar, Reforma në administratën publike, si pjesë e MSA-së, si pjesë e agjendës evropiane dhe modernizimit të administratës publike, ka kornizë legjislative primare, ndërsa lidhur me dokumentet e politikave qeveritare, ekzistojnë dokumente që përmbajnë të ashtuquajturën pako strategjike për reformimin e administratës, të cilat në vete ngërthejnë tri strategji: strategjinë për modernizimin e administratës publike 2015-2020, strategjia për ndryshimin e ligjeve në fuqi 2017-2021 dhe strategjia për koordinimin e politikave për reformimin e menaxhimit të financave publike, të cilat janë në përputhje me kërkesat e Komisionit Evropian dhe parimet e SIGMA-së.

Vlen të theksohet se ekziston një vizion koherent për reformën e administratës publike në nivelin qendror dhe nga ana tjetër të gjitha dokumentet përmbajnë edhe sfidat, objektivat, hapat kyç që priten të përmirësohen.

Sa i përket çështjeve konkrete dhe zhvillimeve të fundit, MAP, me ndihmën e SIGMA-së, ka hartuar koncept-dokumentet e nevojshme për hartimin e pakos së legjislacionit për reformën e administratës publike. Qeveria e Kosovës ka proceduar Projektligjin për pagat, por pastaj e ka tërhequr sipas rekomandimeve të Komisionit Evropian, me arsyen se projektligji në fjalë, të procedohet në pako me disa projektligje: Projektligjin për shërbimin civil. Gjatë vitit 2016, MAP ka realizuar studimin e rishikimit të agjencive dhe bordeve të emëruara nga Kuvendi dhe këtë vit ka zbatuar konkluzionet që ndërlidhen me organizimin e administratës publike. Grupi punues ka adresuar të gjeturat e studimit, dhe mbi bazën e studimit, MAP ka hartuar një memorandum bashkëpunimi, që do të nënshkruhet me Kuvendin e Kosovës, me të cilin përcaktohen prioritetet dhe sfidat e agjencive.

Është me rëndësi të ceket që nga SIGMA është vlerësuar progres i administratës publike, mbi bazën e mbledhjes së të dhënave nga institucionet.

Lahi Brahimaj, pyeti: Pse raporti për çështjen që po diskutohet nuk i është dorëzuar komisionit paraprakisht? Sa janë të punësuar në administratën publike dhe çfarë është koordinimi i MAP -së me Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për nëpunësit e larguar nga puna dhe të cilët, sipas vendimeve të Këshillit, duhet të kthehen në punë?

Zenun Pajaziti, theksoi se në Raportin e Progresit është cekur, si sfida për Kuvendin, mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve. Lidhur me këtë dhe për reformimin e administratës publike, pyeti: Cilat janë sfidat që Kuvendi duhet të fokusohet, qoftë për plotësim-ndryshimin e ligjeve apo edhe të ngritjes së vullnetit politik?

Shqipe Pantina, pyeti lidhur me ngecjet e zbatimit të strategjisë së dytë, meqë në Kuvend ende nuk është adresuar ndonjë raport për reformën e administratës publike, përveç raportit të hartuar nga instituti GAP për zbatimin e planit të veprimit, në të cilin janë identifikuar se nuk janë përmbushur asgjysma e objektivave nga ato sa janë planifikuar.

Sa shkelje ligjore ka identifikuar MAP për shërbyesit civilë, të cilët mbajnë edhe pozita të tjera të emëruara me mandate, çka ka ndihmuar MAP në ngritjen e kapaciteteve të IKAP-it?

Zafir Berisha, pyeti: Cilat janë ngecjet në administratën publike dhe a është administrata publike në përputhje me gjendjen ekonomike të vendit dhe numrin e banorëve, çfarë masash ka

ndërmarrë MAP për shërbyesit civilë, të cilit mbajnë edhe pozita të emëruara në borde, agjenci, sa është dëmtuar buxheti nga ata?

Sadri Ferati, pyeti lidhur me dokumentet për administratën publike.- A janë të kompletuara dhe a duhet të prezantohen?

Xhevahire Izmaku, kërkoi nga ministri, për pyetjet e anëtarëve të Komisionit, për të cilat nuk ka përgjigje aty për aty, t'i sjellin me shkrim.

Mahir Yagcilar, u përgjigj në pyetjet e deputetëve si vijon:

Lidhur me raportin me shkrim për anëtarët e Komisionit, ai tha se nuk ka pranuar ndonjë pyetje konkrete me ftesën për takim, por u deklarua se nëçdo kohë është gatshëm të përgjigjet në të gjitha pyetjet e deputetëve, edhe kur ata i parashtrojnë jashtë takimit, në formë elektronike.

Me Projektligjin për pagat, nuk ka ulje të pagave, sidomos për sektorin shëndetësor, sektorin publik, arsim, ndërsa do të nivelohen pagat për pozitat e larta drejtuese dhe për sektorët politikë.

Sa i përket koordinimit me Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil në Kosovë, MAP-ja, bashkë me Këshillin, ka punuar në rregulloren për rekrutimin e shërbyesve civilë, ndërsa lidhur me zbatimin e vendimeve të Këshillit, sipas së cilave nëpunësi duhet të kthehet në vendin e punës, ministria nuk ka kompetencë, përveç kur kërkohet ndonjë e dhënë nga MAP-ja, për rastet kur zyrtarët e MAP-së kanë paraqitur ankesë në Këshill.

Lidhur me zbatimin e strategjisë për reformën në administratën publike, ekzistojnë raportet periodike dhe vjetore dhe ato janë të publikuara.

MAP-ja, nëçdo fund vit kalendarik, kërkon mjete për realizimin e objektivave të IKAP-it, por buxheti për institucionin në fjalë është buxhet i strukturuar që nuk lejon mundësi të tejkalimeve, por janë hartuar raportet vjetore për numrin e shërbyesve civilë, të cilët janë trajnuar, ndërsa që me ndryshimet në Ligjin për shërbimin civil, ministria do të inkorporojë një nen, me të cilin do të përcaktohet se shërbyesit civilë do të trajnohen vetëm nga IKAP dhe jo edhe nga institucionet tjera.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, për vitin 2016

Xhevahire Izmaku, tha se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, konform ligjit, raporton në Kuvend me raport vjetor për punën, ku sipas raportit vlerësohet se është bërë një punë efikase dhe profesionale.

Shkëmb Manaj, (kryetar i KPMSHCK), njoftoi komisionin që raporti përmban punët e kryera, në kuadër të funksionimit të zgjidhjes së ankesave për vitin 2016, të shërbyesve civilë dhe kandidatëve të cilët kanë aplikuar në shërbimin civil, funksionet e vëzhgimit të procedurës së emërimit të nëpunësve civilë në pozitat e larta drejtuese, si dhe funksionet e zbatimit dhe mbikëqyrjes së rregullave dhe parimeve të legjislacionet në fuqi.

Në raport janë të paraqitura edhe përfaqësimi i Këshillit në procedurat gjyqësore. Gjithashtu, në tabela të raportit janë të shënuara edhe të gjitha të dhënat për secilin institucion. Ankesat e shqyrtuara, ankesat e hedhura, jokompetenca e Këshillit për raste të caktuara të ankesave, etjetera, të cilat janë të publikuara.

Zafir Berisha, pyeti:Çfarë masash ka ndërmarrë Këshilli ndaj atyre punëdhënësve, të cilët nuk kanë zbatuar vendimet e Këshillit?

Shkëmb Manaj,tha se të gjitha të dhënat edhe për përgjegjësinë e punëdhënësve për moszbatimin e vendimeve, janë tëinkorporuar në raport dhe të publikuara.

Konstatim:Komisioni miratoi raportin unanimitisht dhe nxori:

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet Raporti vjetor i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2016.
2. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet deputetja, Xhevahire Izmaku, kryetare e Komisionit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 19 të Ligjit nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ia paraqet Raportin vjetor të punës, Kuvendit të Kosovës.

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në mbledhjen e mbajtur më 29.3.2017, shqyrtoi Raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2016 dhe vlerësoi se Raporti vjetor i punës është në pajtim me nenin 19 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

4. Të ndryshme

Shqipe Pantina, u deklarua se ka vërejtje rreth mënyrës së vendosjes për udhëtimet zyrtare të anëtarëve tëKomisionit, pa miratim nga komisioni.

Mbledhja përfundoi në orën: 13:30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Xhevahire Izmaku